



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Agjencia kundër Korrupsionit
Agencija protiv Korupcije / Anti-Corruption Agency

Analizë

Mbi ndjekjen dhe gjykimet e rasteve korruptive në Kosovë

2013

Prishtinë, AKK, Qershor 2013

Përmbajtja:

| | |
|---|----|
| HYRJE..... | 2 |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT | 3 |
| POLICIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS..... | 5 |
| ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS | 7 |
| DOGANAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS..... | 7 |
| PROKURORITË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS | 8 |
| GJYKATAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS | 9 |
| ANALIZA | 12 |
| KONKLuzionET | 16 |
| MËSIMET DHE REKOMANDIMET | 16 |
| LISTA E TABELAVE: | 17 |

HYRJE

Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme institucionale korrupsioni në Kosovë mbetet njeri prej problemeve më shqetësues në shoqërinë kosovare. Mos marrja e hapave të fuqishëm kundër ë korrupsionit kjo dukuri rrezikon funksionimin e shtetit të së drejtës dhe ndikon negativisht në jetën e përditshme të qytetarëve.

Kosova ka ndërmarrë veprime konkrete që synojnë luftimin dhe parandalimin e kësaj dukurie negative. Korniza ligjore kundër korrupsionit është kompatible me standardet ndërkombëtare. Janë themeluar të gjitha institucionet e nevojshme për ta luftuar korrupsionin, si dhe në shkurt të këtij viti është miratuar Strategjia e re dhe Plani i Veprimit kundër Korrupsionit për periudhën 2012-2017.

Agjencia kundër Korrupsionit (në vijim AKK) si një mekanizëm qendror për parandalimin dhe Luftimin e korrupsionit sipas nenit 5 paragrafi 1 pika 1.14 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit (Ligji nr.03/L-159) ka kompetencë që të mbledhë, analizon dhe publikon të dhënat statistikore ose të dhëna të tjera në lidhje me gjendjen e korrupsionit në Kosovë. Si rezultat i kësaj bashkë me të dhënat e Agjencisë janë mbledhur të dhënat statistikore të rasteve të dyshuara korruptive edhe nga institucionet tjera relevante që kanë për detyrë ligjore hetimin dhe ndjekjen e veprave penale me natyrë korruptive, **si Policia e Kosovës (PK), Doganat e Kosovës (DK), Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), Prokuroritë dhe Gjykatat.**

Ky raport me këto të dhëna statistikore të cilin e realizon Agjencia si i tillë do t'iu shërbej të gjithë atyre që janë të interesuar të din përkitazi me atë, se sa po luftohet korrupsioni në Kosovë.

Raporti përmbledhë saktë të dhënat statistikore në lidhje me atë se si institucionet që kanë për mision luftën kundër korrupsionit i'u kanë qasur këtij problemi dhe se si ato i kanë trajtuar dhe ndjekur kryerësit e veprave korruptive apo edhe dënuar ata.

Raporti përmban edhe pjesën analitike të të dhënave të ofruara, si dhe krahasimin e punës në mes të viteve 2011-2012 të të gjitha institucioneve të përfshira në të.

Pjesët në vijim pasqyrojnë punën për vitin 2012 të Agjencisë kundër Korrupsionit, Doganave, Administratës Tatimore të Kosovës, Policisë së Kosovës, Prokurorive dhe Gjykatave të Republikës së Kosovës, në aktivitetet që këto institucione kanë zhvilluar në ndjekjen dhe gjykimin e veprave penale me natyrë korruptive.

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT

AKK procedurën e hetimit paraprak për rastet e dyshuara për korrupsion e ka zhvilluar kryesisht në mbështetje të kapitullit XXIX të Kodit Penal të Kosovës;- veprat penale kundër Detyrës Zyrtare si dhe në Kapitullin XXII të Kodit Penal të Kosovës; - veprat penale kundër Ekonomisë.

Në vitin 2012, AKK ka pranuar shumë informata për dyshime se persona të caktuar mund të jenë përfshirë në veprime korruptive. Në 164 raste AKK ka gjetur elemente bazë për fillimin e hetimeve ndaj tyre. Ndërsa pas përfundimit të procedurave hetimore paraprake AKK ka konstatuar se prej 164 rasteve të raportuara për korrupsion në 52 ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim të arsyeshëm se rasti mund të përbëjë vepër penale.

Në këto 52 raste ku përfshihen 159 persona AKK ka ushtruar kallëzime penale dhe të njëjtat i ka përcjellë tek Policia e Kosovës dhe Prokuroritë kompetente për procedim të mëtutjeshëm penal për këto vepra të dyshuara me natyrë korruptive.

Ndërsa, në 7 raste pas përfundimit të procedurave hetimore paraprake është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim të arsyeshëm se rasti mund të përbëjë vepër penale, por është dyshuar për shkelje administrative, dhe Agjencia këto raste i ka përcjell në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore.

Rastet e përcjella nga AKK sipas strukturës së veprave penale:

1. Shpërdorim i Pozitës Zyrtare dhe Autorizimit

Bazuar në nenin 339 të Kodit Penal të Kosovës, AKK ka përcjell në Policinë e Kosovës dhjetë (10) raste ku janë përfshirë (26) persona, ndërsa në prokurorit kompetente vendore dhe të EULEX-it janë përcjell 36 raste, ku janë të përfshirë 124 persona. Numri total i rasteve që janë përcjell në Polici dhe Prokuroritë e Kosovës dhe të EULEX-it është 46 raste, derisa në to janë të përfshirë 108 persona nën dyshimin se kanë kryer vepër penale: shpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimit. Kjo vepër në disa raste është përcjellë së bashku me vepra tjera penale.

2. Përvetësimi gjatë Ushtrimit të Detyrës

Bazuar në neni 340 të Kodit Penal të Kosovës, AKK ka përcjell në Prokurori kompetente 1 rast, ku është i përfshirë 1 person.

3. Marrje Ryshfetit

Bazuar në nenin 343 të Kodit Penal të Kosovës, AKK ka përcjell në polici 2 raste, ku janë të përfshirë 2 persona.

4. Dhënie Ryshfeti

Bazuar në nenin 344 të Kodit Penal të Kosovës, AKK ka përcjell në polici 1 rast, ku janë të

përfshirë 3 persona.

5. Lidhja e Kontratës së Dëmshme

Bazuar në nenin 237 të Kodit Penal të Kosovës, AKK ka përcjell në Prokurori kompetente 1 rast, ku janë të përfshirë 2 persona.

6. Legalizimi i Përmbajtjes së Pavërtetë

Bazuar në nenin 334 të Kodit Penal të Kosovës, AKK ka përcjell në Prokurori kompetente 1 rast, ku është i përfshirë 1 person.

Tabela në vazhdim (*Tabela 1*) pasqyron të dhënat e sakta të denoncimeve të AKK-së në Polici dhe kallëzimet penale në Prokurorit e Kosovës.

Këto të dhëna statistikore janë paraqitur edhe në tabelën e më poshtme (*Tabela 1*).

| Agjencia kundër Korrupsionit | | | | | |
|--|-------------------------------|--|---|------------------|--------------------|
| Lloji i veprës penale sipas Kodit Penal | Neni i Kodit Penal të Kosovës | Numri i rasteve të përcjella në Polici | Numri i rasteve të përcjella në Prokurori | Gjithsejtë raste | Gjithsejtë Persona |
| Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit | 339 | 10 | 36 | 46 | 150 |
| Përvetësimi gjatë Ushtrimit të Detyrës | 340 | 0 | 1 | 1 | 1 |
| Marrje Ryshfetit | 343 | 2 | 0 | 2 | 2 |
| Dhënie Ryshfetit | 344 | 1 | 0 | 1 | 3 |
| Lidhja e Kontratës së Dëmshme | 237 | 0 | 1 | 1 | 2 |
| Legalizim i Përmbajtjes së Pavërtetë | 334 | 0 | 1 | 1 | 1 |
| Gjithsejtë: | | 13 | 39 | 52 | 159 |

Tabela 1. Të dhënat statistikore për rastet e hetuara për korrupsion dhe të përcjella në organet kompetente për procedim të mëtutjeshëm penal nga Agjencia kundër Korrupsionit

Për më tej, AKK me legjislacionin dytësor e ka të rregulluar mënyrën e trajtimit të rasteve nga momenti i pranimit të informacionit nga qytetari deri te përcjella e rastit në organet kompetente apo edhe hedhja dhe mbyllja e rastit si i pabazuar.

AKK ka një raport të mirë komunikimi me Prokurorin e shtetit dhe në shumicën e rasteve AKK e merr informacionin kthyesë për rastet (kallëzimet penale) që ajo i paraqet në prokurori.

AKK e njofton qytetarin (raportuesin) për çdo hap që merret në raport me rastin e raportuar.

POLICIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Policia e Republikës së Kosovës gjegjësisht Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit me informatat që i ka pranuar gjatë vitit 2012 ka punuar në gjithsejtë njëqind e shtatëdhjetë e nëntë (179) raste të dyshuara për vepra korruptive. Prej këtyre 179 rasteve, 39 raste janë nën hetime, 139 raste janë dërguar në Prokurori me kryes të njohur dhe 1 rast është dërguar në Prokurori me N/N. Policia ka ushtruar kallëzime penale ndaj 266 personave të dyshuar.

Rastet e trajtuara nga Policia e Kosovës sipas strukturës së veprave penale:

1. Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit

Sipas nenit 339 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

Tridhjetë e katër (34) raste nën hetime,
Tetëdhjetë e një (81) raste i ka dërguar në Prokurori me kryerës të njohur,
Një (1) rast me N/N, dhe
Kundër njëqind e nëntëdhjetë e shtatë (197) personave ka ushtruar kallëzim penal.

2. Përvetësim Gjatë Ushtrimit të Detyrës

Sipas nenit 340 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

Një (1) rast nën hetime,
Shtatë (7) raste i ka dërguar në Prokurori me kryerës të njohur, dhe
Kundër shtatë (7) personave ka ushtruar kallëzim penal.

3. Mashtrimi në Detyrë

Sipas nenit 341 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

Dy (2) raste i ka dërguar në Prokurori me kryerës të njohur, dhe
Kundër pesë (5) personave ka ushtruar kallëzim penal.

4. Marrja e Ryshfetit

Sipas nenit 343 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

Një (1) rast nën hetime,
Trembëdhjetë (13) raste i ka dërguar në Prokurori me kryerës të njohur, dhe
Kundër Gjashtëmbëdhjetë (16) personave ka ushtruar kallëzim penal.

5. Dhënia e Ryshfetit

Sipas nenit 344 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

Dy (2) raste nën hetime,
Njëzet e gjashtë (26) raste i ka dërguar në Prokurori me kryerës të njohur, dhe
Kundër njëzet e shtatë (27) personave ka ushtruar kallëzim penal.

6. Ushtrimi i Ndikimit

Sipas nenit 345 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

Një (1) rast e ka dërguar në Prokurori me kryerës të njohur, dhe
Kundër një (1) personi ka ushtruar kallëzim penal.

7. Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare

Sipas nenit 348 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

Një (1) raste nën hetime,
Nëntë (9) raste i ka dërguar në Prokurori me kryerës të njohur, dhe
Kundër trembëdhjetë (13) personave ka ushtruar kallëzim penal.

Për të gjitha llojet e veprave penale të lartpërmendura Policia e Kosovës gjegjësisht Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe kundër Korrupsion ka hetuar 179 raste dhe ka ngritur kallëzim penal ndaj 266 personave. Prej 179 rasteve të lartpërmendura, 139 raste i ka dërguar në Prokurori me kryerës të njohur, 1 rast me kryes N/N dhe 39 të tjera janë nën hetime.

Këto të dhëna statistikore janë paraqitur edhe në tabelën e më poshtme (*Tabela 2*).

| Policia e Kosovës | | | | | | |
|--|-------------------------------|-----------------|---|-----------------------------|-----------------|--|
| Lloji i veprës penale sipas Kodit Penal | Neni i Kodit Penal të Kosovës | Numri i rasteve | Dërguar në Prokurori me kryerës të njohur | Dërguar në Prokurori me N/N | Rast nën hetime | Kallëzime penale të ushtruara kundër personave |
| Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit | 339 | 116 | 81 | 1 | 34 | 197 |
| Përvetësimi gjatë Ushtrimit të Detyrës | 340 | 8 | 7 | 0 | 1 | 7 |
| Mashtrimi në Detyrë | 341 | 2 | 2 | 0 | 0 | 5 |
| Marrja e Ryshfetit | 343 | 14 | 13 | 0 | 1 | 16 |
| Dhënia e Ryshfetit | 344 | 28 | 26 | 0 | 2 | 27 |
| Ushtrimi i Ndikimit | 345 | 1 | 1 | 0 | 0 | 1 |

| | | | | | | |
|--|-----|-----|-----|---|----|-----|
| Falsifikimi i Dokumenteve Zyrtare | 348 | 10 | 9 | 0 | 1 | 13 |
| Gjithsejtë: | | 179 | 139 | 1 | 39 | 266 |

Tabela 2. Të dhënat statistikore për rastet e hetuara për korrupsion nga Policia e Kosovës

ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) gjatë vitit 2012, ka pranuar 7 raste për keq sjellje, neglizhencë, kërcënime, korrupsion, etj. Prej këtyre rasteve, 3 raste janë hetuar nga ZSP-ja (Zyra e Standardeve Profesionale), dhe katër 4 raste janë adresuar në Policinë e Kosovës, respektivisht në Drejtorinë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit.

ATK po ashtu bënë të ditur se nga tri (3) rastet e hetuara nga ZSP-ja nën dyshimet për shkeljen e rregullave të kodit të mirësjelljes (p.sh. moslajmërimin e afërsisë me kontabilist, etj.) në dy (2) raste ka rekomanduar vërejtje me shkrim dhe në një (1) rast është shqiptuar masa disiplinore pezullim i përkohshëm nga puna.

DOGANAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Dogana e Kosovës gjatë vitit 2012, aktivitetet e saj në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit, i ka seleksionuar në dy sektor: Sektori për Inspektim të Brendshëm i Doganës dhe Sektori i Standardeve Profesionale.

Sektori për Inspektim të Brendshëm i Doganës gjatë vitit 2012, ka inspektuar në teren, ka raportuar zyrtarë në procedura disiplinore dhe ka rekomanduar për përmirësim të sistemit, si në vijim:

- Inspektime në teren dhe të procedurave 24,
- Zyrtarë të raportuar në procedura disiplinore 6, dhe
- Rekomandime për përmirësim të sistemit 44.

Ndërsa Sektori i Standardeve Profesionale gjatë vitit 2012, ka raportuar, ka shqiptuar masa disiplinore, dhe ka proceduar raste në Gjykata apo Polici, si në vijim:

- Raste të raportuara 17,
- Masa disiplinore të shqiptuara 19, dhe
- Raste të proceduara në Gjykata apo Polici 5.

PROKURORITË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Prokuroritë e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2012 kanë punuar në 643 kallëzime penale kundër 1670 personave të dyshuar për vepra penale kundër detyrës zyrtare. Prej numrit 643 të kallëzimeve penale sa kanë qenë të trajtuara gjatë vitit 2012, 267 prej tyre me 802 persona janë bartur nga viti paraprak, ndërsa 376 kallëzime penale me 868 persona janë pranuar gjatë vitit 2012.

Nga numri i 643 kallëzimeve penale që kanë qenë në punë, Prokuroritë kanë zgjedhur 366 kallëzime penale me 770 persona. Të pazgjidhura kanë mbetur 277 kallëzime me 900 persona.

Prokuroritë lidhur me kallëzimet penale që kanë qenë në punë gjatë vitit 2012 kanë marrë këto vendime për 770 persona :

- Kundër 158 personave është hedhur kallëzimi penal,
- Kundër 2 personave janë pezulluar hetimet,
- Kundër 97 personave janë pushuar hetimet,
- Kundër 5 personave është hequr dorë nga ndjekja penale,
- Kundër 140 personave është ngritur propozim akuzë,
- Kundër 24 personave është ngritur propozim akuzë për dhënien e urdhrin ndëshkimor,
- Kundër 26 personave është ngritur aktakuzë e drejtpërdrejtë,
- Kundër 106 personave është ngritur aktakuzë pas hetimit,
- Kundër 20 personave kallëzimi penal është zgjidhur në mënyrë tjetër dhe
- Rastet e 192 personave janë dërguar në kompetencë.

Këto të dhëna statistikore janë paraqitur edhe në tabelën e më poshtme (*Tabela 3*).

| Prokuroritë | | | | | | | |
|---|------------------------------|---------------------------|--|---------------------|--------------------|---|--------------------------------------|
| Lloji i veprave penale sipas Kodit Penal | Është hedhur kallëzimi penal | Ngritja e propozim akuzës | Ngritja e propozim akuzës për dhënien e urdhrin ndëshkimor | Ngritja e aktakuzës | Pushimi i hetimeve | Kallëzimi penal është zgjedhur në mënyrë tjetër | Kallëzimet e mbetura në vitin vijues |
| Veprat penale kundër detyrës zyrtare kapitulli XXIX | 158 | 140 | 24 | 132 | 97 | 20 | 277 |

Tabela 3. Statistikat e zgjidhjes së kallëzimeve penale për persona përkitazi me korrupsionin në Prokuroritë e Kosovës gjatë vitit 2012

GJYKATAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Gjykatat e Republikës së Kosovës (komunale dhe të qarkut) gjatë vitit 2012 kanë zgjidhur gjithsejtë 183 lëndë me natyrë korruptive.

Gjykatat gjatë këtij viti kanë gjykuar për këto lloje të veprave penale kundër detyrës zyrtare:

1. Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit

Sipas nenit 339 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kanë shqiptuar këto aktgjykime:

Dhjetë (10) dënime me burgim,
Trembëdhjetë (13) dënime me gjobë,
Pesëmbëdhjetë (15) dënime me kusht,
Dymbëdhjetë (12) Aktgjykim lirues,
Tetë (8) Aktgjykim refuzues, dhe
Tridhjetë e tetë (38) janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

2. Përvetësim Gjatë Ushtrimit të Detyrës

Sipas nenit 340 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kanë shqiptuar këto aktgjykime:

Pesë (5) dënime burgim,
Nëntë (9) dënime me kusht,
Një (1) Aktgjykim lirues,
Dy (2) Aktgjykim refuzues, dhe
Dy (2) janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

3. Përdorim i Paautorizuar i Pasurisë

Sipas nenit 342 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kanë shqiptuar këto aktgjykime:

Dy (2) dënime me gjobë,
Dy (2) dënime me kusht, dhe
Një (1) është zgjidhur në mënyrë tjetër .

4. Marrja e Ryshfetit

Sipas nenit 343 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kanë shqiptuar këto aktgjykime:

Katër (4) dënime me burg,
Shtatë (7) dënime me gjobë,

Katër (4) dënime me kusht
Pesë (5) Aktgjykim lirues
Një (1) është zgjidhur në mënyrë tjetër.

5. Dhënia e Ryshfetit

Sipas nenit 344 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kanë shqiptuar këto aktgjykime:

Njëzet e katër (24) dënime me gjobë,
Dy (2) dënime me kusht,
Tri (3) dënime tjetër, dhe
Dy (2) janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

6. Ushtrimi i Ndikimit

Sipas nenit 345 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kanë shqiptuar këto aktgjykime:

Një (1) është zgjidhur në mënyrë tjetër.

7. Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve Gjyqësore

Sipas nenit 346 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kanë shqiptuar këto aktgjykime:

Dy (2) Aktgjykim lirues, dhe
Një (1) është zgjidhur në mënyrë tjetër.

8. Zbulimi i fshehtësive zyrtare

Sipas nenit 347 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kanë shqiptuar këto aktgjykime:

Një (1) dënime me kusht, dhe
Një (1) është zgjidhur në mënyrë tjetër

9. Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare

Sipas nenit 348 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kanë shqiptuar këto aktgjykime:

Dy (2) dënime me kusht,
Një (1) Aktgjykim lirues,
Një (1) Aktgjykim refuzues dhe
Një (1) është zgjidhur në mënyrë tjetër.

Këto të dhëna statistikore janë paraqitur edhe në tabelën e më poshtme (Tabela 4).

| Gjykatat | | | | | | | | | |
|--|-------------------------------|---------------|----------------|----------------|--------------|------------------|--------------------|------------------------------|-------------------------------|
| Lloji i veprës penale sipas Kodit Penal | Neni i Kodit Penal të Kosovës | Dënim me Burg | Dënim me Gjobë | Dënim me Kusht | Dënim tjetër | Aktgjykim Lirues | Aktgjykim Refuzues | Të zgjidhur në mënyrë tjetër | Gjithsejtë Lëndë të zgjidhura |
| Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit | 339 | 10 | 13 | 15 | 0 | 12 | 8 | 38 | 96 |
| Përvetësimi gjatë Ushtrimit të Detyrës | 340 | 5 | 0 | 9 | 0 | 1 | 2 | 2 | 19 |
| Mashtrimi në Detyrë | 341 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Përdorimi i Paautorizuar i Pasurisë | 342 | 0 | 2 | 2 | 0 | 0 | 0 | 1 | 5 |
| Marrja e Ryshfetit | 343 | 4 | 7 | 4 | 0 | 5 | 0 | 1 | 21 |
| Dhënia e Ryshfetit | 344 | 0 | 24 | 2 | 3 | 0 | 0 | 2 | 31 |
| Ushtrimi i Ndikimit | 345 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 |
| Nxjerrja e Kundërligjshme e Vendimeve Gjyqësore | 346 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 1 | 3 |
| Zbulimi i Fshehtësive Zyrtare | 347 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 | 2 |
| Falsifikimi i Dokumenteve Zyrtare | 348 | 0 | 0 | 2 | 0 | 1 | 1 | 1 | 5 |
| Arkëtimi dhe Pagesa e Paligjshme | 349 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Lirimi i Kundërligjshëm i Personit të Privuar nga Liria | 350 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Përvetësimi i Kundërligjshëm i Pasurisë me Rastin e Bastisjes apo Ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor | 351 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Gjithsejtë: | | 19 | 46 | 35 | 3 | 21 | 11 | 48 | 183 |

Tabela 4. Të dhënat statistikore të gjykimeve që janë shqiptuar nga Gjykatat e Kosovës për rastet korruptive gjatë vitit 2012

ANALIZA

Agjencia kundër Korrupsionit, gjatë vitit raportues 2012 ka ushtruar 52 kallëzime penale, kundër 159 personave. Në këto raste të ndjekjes kanë qenë të angazhuar 11 zyrtar të Agjencisë, respektivisht nga Departamenti për Luftimin e Korrupsionit.

Dogana e Kosovës, gjatë vitit raportues 2012, nëpërmes dy sektorëve (Sektori për Inspektim të Brendshëm dhe Sektori për Standarde Profesionale) i ka realizuar disa aktivitete, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit. Nuk është raportuar për ushtrimin e ndonjë kallëzimi penal. Janë raportuar 5 raste të cilat janë përcjell në Polici.

Administrata Tatimore e Kosovës, nuk ka raportuar të ketë ushtruar kallëzime penale, ndërsa 4 raste janë përcjell në Polici- Drejtorinë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit.

Policia e Kosovës, konkretisht Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, i ka përcjell në prokuroritë kompetente 140 raste, kundër 266 personave. Kjo drejtori ka një staf prej rreth 120 zyrtarëve.

Në vijim në formë tabelore pasqyrohet numri i kallëzimeve penale që institucionet e lartë përmendura i kanë adresuar tek prokurorit kompetente (*Tabela 5*).

| Kallëzimet Penal | | |
|------------------------------|-----------------|-------------------|
| Institucioni: | Numri i rasteve | Numri i personave |
| Agjencia kundër Korrupsionit | 52 | 159 |
| Policia e Kosovës | 140 | 266 |
| Dogana e Kosovës | 0 | 0 |
| Administrata Tatimore | 0 | 0 |
| Gjithsejtë: | 192 | 425 |

Tabela 5. Kallëzimet penale nga AKK, PK, DK, ATK

Prokuroritë e Republikës së Kosovës, gjatë vitit raportues 2012 nga burime të ndryshme kanë pranuar në punë 376 kallëzime penale kundër 868 personave.

Prokuroritë nga trajtimi i përgjithshëm i kallëzimeve penale kanë ushtruar:

Propozim akuzë kundër 140 personave;

Propozim akuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor kundër 24 personave;

Aktakuzë e drejtpërdrejtë kundër 26 personave;
Aktakuzë pas hetimit kundër 106 personave.
Gjithsejtë propozim akuza dhe aktakuza janë ngritur kundër 296 personave.

Në vijim në formë tabelore pasqyrohet numri i propozim akuzave dhe aktakuzave të ngritura nga Prokuroritë e Kosovës (Tabela 6).

| Prokuroritë e Kosovës | | |
|--|-----------------|-------------------|
| | Numri i rasteve | Numri i personave |
| Propozim akuza | 0 | 140 |
| Propozim akuzë për dhënien e urdhërit ndëshkimor | 0 | 24 |
| Aktakuzat | 0 | 132 |
| Gjithsejtë: | 0 | 296 |

Tabela 6. Propozim akuzat dhe Aktakuzat nga Prokuroritë

Gjykatat e Kosovës, gjatë vitit 2012 i kanë zgjidhur gjithsejtë 183 lëndë me natyrë korruptive. Prej tyre në 19 raste janë shqiptuar dënime me burg, 46 dënime me gjobë, 35 dënime me kusht, 3 dënim tjetër, 21 Aktgjykime lirues, 11 Aktgjykime refuzuese, 48 të zgjidhura në mënyrë tjetër.

Në vijim në formë tabelore pasqyrohet numri i rasteve të zgjidhura nga Gjykatat (Tabela 7).

| Dënimet e shqiptuara nga Gjykatat | | | | | |
|-----------------------------------|---------|----------|----------|----------|------------|
| | Me burg | Me gjobë | Me kusht | Të tjera | Gjithsejtë |
| Gjykatat Komunale | 9 | 46 | 23 | 3 | 81 |
| Gjykatat e Qarkut | 10 | 0 | 12 | 0 | 22 |
| Gjithsejtë: | 19 | 46 | 35 | 3 | 103 |

Tabela 7. Dënimet e shqiptuara nga Gjykatat e Kosovës

Kallëzimet penale, propozim akuzat, aktakuzat dhe dënimet e shqiptuara me burg pasqyrohen si në vijim (Tabela 8).

| Institucioni | Kallëzime penale | Propozim akuza/Aktakuza | Dënime me burg |
|---------------------------------|------------------|-------------------------|----------------|
| Agjencia kundër Korrupsionit | 52 | 0 | 0 |
| Policia e Kosovës | 140 | 0 | 0 |
| Dogana e Kosovës | 0 | 0 | 0 |
| Administrata Tatimore e Kosovës | 0 | 0 | 0 |
| Prokuroritë | 0 | Kundër 296 personave | 0 |
| Gjykatat | 0 | 0 | 19 |

Tabela 8. Pasqyra përmbledhëse e kallëzimeve penale, propozim akuzave, aktakuzave dhe dënimeve të shqiptuara me burg.

Karakteristikat e përgjithshme të veprave të natyrës korruptive për të cilat është ushtruar

kallëzim penal pasqyrohen si në vijim (Tabela 9).

| Veprat Penale | AKK | Policia | Gjithsejtë |
|--|-----------|------------|------------|
| Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit (339) | 46 | 81 | 127 |
| Përvetësimi gjatë Ushtrimit të Detyrës (340) | 1 | 7 | 8 |
| Mashtrimi në Detyrë (341) | 0 | 2 | 2 |
| Marrja e Ryshfetit (343) | 2 | 13 | 15 |
| Dhënia e Ryshfetit (344) | 1 | 26 | 27 |
| Ushtrimi i Ndikimit (345) | 0 | 1 | 1 |
| Falsifikimi i Dokumenteve Zyrtare (348) | 0 | 9 | 9 |
| Lidhja e Kontratës së Dëmshme | 1 | 0 | 1 |
| Legalizimi i Përmbajtjes së Pavërtetë | 1 | 0 | 1 |
| Gjithsejtë: | 52 | 139 | 191 |

Tabela 9. Kallëzimet penale të AKK-së dhe PK sipas llojit të veprës penale

Ngritja e propozim akuzave dhe aktakuzave sipas natyrës së veprës penale është e pamundur të paraqitet për secilën prej tyre veç e veç, sepse statistikat e ofruara janë të përmbledhura për tërë kapitullin e veprave penale kundër detyrës zyrtare.

Tabela në vijim pasqyron shqiptimin e dënimeve nga ana e gjykatave sipas llojit të veprës (Tabela 10).

| Veprat Penale | Gjykimet | | | | Gjithsejtë |
|--|---------------|----------------|----------------|--------------|------------|
| | Dënim me burg | Dënim me gjobë | Dënim me kusht | Dënim tjetër | |
| Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit (339) | 10 | 13 | 15 | 0 | 38 |
| Përvetësimi gjatë Ushtrimit të Detyrës (340) | 5 | 0 | 9 | 0 | 14 |
| Përdorimi i Paautorizuar i Pasurisë (342) | 0 | 2 | 2 | 0 | 4 |
| Marrja e Ryshfetit (343) | 4 | 7 | 4 | 0 | 15 |
| Dhënia e Ryshfetit (344) | 0 | 24 | 2 | 3 | 29 |
| Zbulimi i Fshehtësive Zyrtare (347) | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 |
| Falsifikimi i Dokumenteve Zyrtare (348) | 0 | 0 | 2 | 0 | 2 |
| Gjithsejtë: | 19 | 46 | 35 | 3 | 103 |

Tabela 10. Gjykimet sipas llojit të veprave penale

Ky raport përtej të dhënave statistikore dhe analizës së hetimeve dhe ndjekjes së veprimeve penale të natyrës korruptive gjatë vitit 2012, pasqyron edhe krahasimin e punës në mes të viteve 2011-2012 të të gjitha institucioneve të përfshira në këtë raport.

Tabela në vijim pasqyron numrin e kallëzimeve penale dhe personave të atakuar në to krahasuar në mes të viteve 2011 dhe 2012 (Tabela 11).

| Vitet | Kallëzime penale | | Personat e përfshirë | |
|------------------------------|------------------|------|----------------------|------|
| | 2011 | 2012 | 2011 | 2012 |
| Agjencia kundër Korrupsionit | 39 | 52 | 121 | 159 |
| Policia e Kosovës | 151 | 139 | 293 | 266 |
| Dogana e Kosovës | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Administrata Tatimore | 0 | 0 | 0 | 0 |

Tabela 11. Rastet e dërguara në prokurori gjate viteve 2011/2012

Tabela në vijim pasqyron numrin e propozim akuzave dhe aktakuzave nga ana e prokurorive të vendit sipas rasteve dhe personave të atakuar krahasuar në mes vitit 2011 dhe 2012 (Tabela 12). Të dhënat statistikore të ofruara për Prokurori për vitin 2012 pasqyrojnë vetëm numrin e personave e jo edhe numrin e rasteve të trajtuara të paraqitur në mënyrë të detajuar. Prandaj tabela në vijim nuk pasqyron numrin e rasteve për vitin 2012.

| Propozim akuza dhe Aktakuza nga Prokuroritë | | | | |
|---|-------|---------|-------|---------|
| | 2011 | | 2012 | |
| | Raste | Persona | Raste | Persona |
| Propozim akuza | 107 | 139 | 0 | 140 |
| Propozim akuza për dhënien e urdhrin ndëshkimit | 0 | 0 | 0 | 24 |
| Aktakuza | 107 | 477 | 0 | 132 |
| Gjithsejtë: | 214 | 616 | 0 | 296 |

Tabela 12. Propozim akuza dhe Aktakuza të ngritura nga Prokuroritë gjatë vitit 2011/2012

Tabela në vijim pasqyron numrin e shqiptimit të dënimeve nga ana e Gjykatave të vendit të krahasuara në mes vitit 2011 dhe 2012 (Tabela 13).

| Dënimet | | |
|--------------|------|------|
| | 2011 | 2012 |
| Me burg | 20 | 19 |
| Me gjobë | 45 | 46 |
| Me kusht | 25 | 35 |
| Dënime tjera | 1 | 3 |
| Gjithsejtë: | 91 | 103 |

Tabela 13. Dënimet e shqiptuara nga Gjykatat gjatë viteve 2011 dhe 2012

KONKLuzionET

Nga të dhënat statistikore rezulton se numri më i madh i veprave penale të karakterit korruptiv edhe këtë vit i takon Veprës penale, Shpërdorimi i detyrës zyrtare. Për këtë lloj janë shqiptuar 10 dënime me burg, 13 dënime me gjobë dhe 15 dënime me kusht.

Tek Policia e Kosovës numri i kallëzimeve penale krahasuar me vitin 2011 është më i vogël.

Doganat dhe Administrata Tatimore e Kosovës edhe pse në strukturën e tyre organizative kanë njësi që hetojnë nuk kanë ushtruar asnjë kallëzim penal.

Prokuroritë e Kosovës kanë stagnuar në menaxhimin e statistikave rreth rasteve të trajtuara, derisa në vitin 2011 raportuan në mënyrë më specifike për rastet dhe personat e akuzuar, ndërsa këtë vit kanë raportuar vetëm për persona. Në vitin 2011 janë raportuar propozim akuza dhe aktakuza të ngritura kundër 616 personave, ndërsa në vitin 2012 vetëm kundër 296 personave.

Gjykatat e Kosovës për vitin 2011 kishin shqiptuar 20 dënime me burg, ndërsa në vitin 2012 kanë nxjerr vendime për dënime me burg në 19 raste.

Nuk ka progres në sanksionimin e veprave penale kundër korrupsionit.

Raportet në mes Prokurorisë dhe Gjykatës kanë shënuar regres.

MËSIMET DHE REKOMANDIMET

1. Të harmonizohen të dhënat e mekanizmave që kanë për mision luftimin e korrupsionit;
2. Prokuroritë dhe Gjykata duhet të raportojnë për veprimet e tyre në mënyrë më precize. Prokuroritë të raportojnë për rastet dhe për personat e akuzuar;
3. Gjykatat duhet të raportojnë për rastet, për personat e dënuar, si dhe për gjatësinë e dënimeve;
4. Më qëllim të rritjes së transparencës është domosdoshmëri e kohës që aktakuzat dhe aktgjykimet të bëhen publike;
5. Prokuroritë dhe Gjykatat duhet të bëjnë publike raporte periodike për hetimin dhe gjykimin e korrupsionit.

LISTA E TABELAVE:

Tabela 1. Të dhënat statistikore për rastet e hetuara për korrupsion dhe të përcjella në organet kompetente për procedim të mëtutjeshëm penal nga Agjencia kundër Korrupsionit

Tabela 2. Të dhënat statistikore për rastet e hetuara për korrupsion nga Policia e Kosovës

Tabela 3. Statistikat e zgjidhjes së kallëzimeve penale për persona përkitazi me korrupsionin në Prokuroritë e Kosovës gjatë vitit 2012

Tabela 4. Të dhënat statistikore të gjykimeve që janë shqiptuar nga Gjykatat e Kosovës për rastet korruptive gjatë vitit 2012

Tabela 5. Kallëzimet penale nga AKK, PK, DK, ATK

Tabela 6. Propozim akuzat dhe Aktakuzat nga Prokuroritë

Tabela 7. Dënimet e shqiptuara nga Gjykatat e Kosovës

Tabela 8. Pasqyra komulative e kallëzimeve penale, propozim akuzave, aktakuzave dhe dënimeve të shqiptuara me burg.

Tabela 9. Kallëzimet penale të AKK-së dhe PK sipas llojit të veprës penale

Tabela 10. Gjykimet sipas llojit të veprave penale

Tabela 11. Rastet e dërguara në prokurori gjate viteve 2011/2012

Tabela 12. Propozim akuza dhe Aktakuza të ngritura nga Prokuroritë gjatë vitit 2011/2012

Tabela 13. Dënimet e shqiptuara nga Gjykatat gjatë viteve 2011 dhe 2012